



AKT THEMELIMI

E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "A.B.A.U." SHPK

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE,
KOHEZGJATJA.

Ne baze te ligjit nr. 7512, date 10.08.1991 "Per sanksionimin
dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te
veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" dhe ligjit
nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe nenit
64 te ligjit 7667 date 28.01.1993 per regjistrimin e shoqerive
ne Regjistrin Tregtar, me vullnetin e tyre te lire te shprehur
ne nenshkrimin e ketij akti, ortaket:

1. Ahmet Ulaj, i biri i Ises e Zades, i dtl. 1951, banues ne Tirane, rruga Asim Vokshi, nr.. 90/1
 2. Astrit Ulaj, i biri i Ises dhe i Zades, i dtl 1964, banues ne Tirane, rruga Asim Vokshi, nr.90/1.
- Deklarojne se kane lidhur, si me poshte vijon, aktin e themelimit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "A.B.A.U. "shpk

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "A.B.A.U." shpk eshte:

- Import-eksport, tregtimin me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore, elektrike, elektronike, elektroshtepiake, tekstile, prodhime kimike dhe detergjente, materiale ndertimi, veprimtari ne fushen e sherbimeve, transporteve te mallrave dhe udhetareve, hapje restorantesh, bare te ndryshme, hoteleri.
- Import-eksport, shitje me shumice e pakice te karburantit e nenprodukteve te naftes (petrolit), vajrave lubrifikante, ndertimi dhe venia ne shfrytezim e pikave te karburantit per shitblerjen e karburantit dhe nenprodukteve te saj.
- Ndertime civile e publike ne fushen e turizmit
- Ushtrimin e aktivitetit te rojeve civile.
- Shoqeria ka te drejte gjithashtu te bashkepunoje me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ngjajshem me te.

Shoqeria ka te drejte qe ne perputhje me ligjin te hyje ne cfaredo lloj veprimtarie afariste dhe te marre masa per te permbushur cdo detyre qe con ne realizimin e synimeve te saj.

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise me pergegjesi te kufizuar "A.B.A.U." shpk eshte ne TIRANE, rruga Asim Vokshi, nr 90/1 Ajo gezon te drejten te krijoje ose te mbyllte ne Shqiperi apo jashte saj filiale, perfaqesi apo seli te tjera.



JETEGJATESIA E SHOQERISE

Jetegjatesia e shoqerise me perjegjesi te kufizuar "A.B.A.U." shpk eshte mbi 10 vjete. Palet kane te drejte qe me vendim te asamblese se ortakeve te nderpresin kete kohezgjatje para afatit ose te kerkojne rizgjatjen e saj prane Regjistrat Tregtar Tirane.

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise "A.B.A.U.". shpk eshte 100.000 lek, kuotat e te cilit jane te ndara ne kete menyre:

- | | |
|----------------|----------------|
| 1. Ahmet Ulaj | 50% te kuotave |
| 2. Astrit Ulaj | 50% te kuotave |

Kapitali eshte i ndare ne aksione me vlere nominale te barabarte prej 1000 leke.

Kapitali shoqeror mbyllt me 31 dhjetor te cdo viti dhe bilanci duhet aprovuar brenda kater muajve te ardhshme.

Shoqeria e fillon aktivitetin ne momentin e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqerise jane:

- Asambleja e Ortakeve
- Keshilli Administrativ
- Administratori, ose drejtor i per gjithshem

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise me perjegjesi te kufizuar "A.B.A.U." shpk

Te drejtat e paleve ne kete kontrate jane si vijon:

Te marrin pjese ne administrimin dhe drejtimin e shoqerise.

Te marrin pjese ne ndarjen e fitimit sipas kuotave perkatese dhe ne perputhje me statutin.

Ne baze te kuotave qe kane, te marrin pjese ne shperndarjen e aktivit te do te rezultoje mbas daljes se bilancit te likuidimit, ne rast se mbyllt shoqeria.


Detyrimet e paleve ne kete kontrate jane si vijon:

Te derdhin pjesen e tyre ne kapitalin baze, sikurse parashikohet ne kapitalin fillestar te kesaj shoqerie.

Te marrin pjese ne drejtimin dhe administrimin e shoqerise ne perputhje me statutin.

Te ruajne sekretin per gjithcka qe ka te beje me aktivitetin e shoqerise.

Ortaku ka te drejte te heqe dore prej kesaj kontrate sipas normave te statutit, duke lajmeruar te pakten nje vit me pare ortaket e tjere.





Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te rrjedhin nga ky akt, ne rast se nuk kapercehen me vullnet te mire, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane.

Modifikime te mundshme apo shtesa ne kete akt do te kene vlore dhe do te zbatohen vetem ne rast se paraqiten me shkrim te firmosura nga te dy palet, ose, po qe nevoja, te shoqeruara me autorizimet perkatese te instancave kompetente.

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me ane te kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes, zbatohen dispozitat e Kodit te Punes. Kjo eshte e njejte edhe per filialet, zyrat e perfaqesimit apo agjencite.

O R T A K E T

Ahmet Ulaj

Astrit Ulaj

S T A T U T I
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" A.B.A.U. " SHPK

KREU I
EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE,
KOHEZGJATJA

NENI 1

EMERTIMI

Ne baze te ligjit nr.7512, date 10.8.1991 "Per sanksionimin
dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te
veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" dhe ligjit
nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe
nenit 64 te ligjit 7667 date 28.11.1993 per regjistrimin e
shoqerive ne Regjistrin Tregtar, me vullnetin e tyre te lire
te shprehur ne nenshkrimin e kontrates qe i bashkohet ketij
statuti, ortaket:

1. Ahmet Ulaj , i biri i Ises e Zades, i dtl. 1951, banues ne Tirane, rruga Asim Vokshi, nr.. 90/1
2. Astrit Ulaj, i biri i Ises dhe i Zades, i dtl 1964, banues ne Tirane, rruga Asim Vokshi, nr.90/1.

Deklarojne se kane lidhur, si me poshte vijon, statutin e nje
shoqerie me pergjegjesi te kufizuar te emertuar " A.B.A.U. "
Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "A.B.A.U." fiton
personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj ne
Gjykatene Rejhorte Tirane. Ajo eshte person juridik shqiptar
dhe e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me normat e
legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe ato te akteve te saj
themeluese, si ky statut dhe kontrata qe i bashkohet dhe qe
perben nje pjese te pandare te saj.

NENI 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike i shoqerise me pergjegjesi te
kufizuar "A.B.A.U." shpk eshte:

- Import-eksport, tregtimin me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore, elektrike, elektronike, elektroshtepiake, tekstile, prodhime kimike dhe detergjente, materiale ndertimi, veprimtari ne fushen e sherbimeve, transporteve te mallrave dhe udhetareve, hapje restorantesh, bare te ndryshme, hoteleri. .
- Import-eksport, shitje me shumice e pakice te karburantit e nenprodukteve te naftes (petrolit), vajrave lubrifikante, ndertimi dhe venia ne shfrytezim e pikave te karburantit per shitblerjen e karburantit dhe nenprodukteve te saj.
- Ndertime civile e publike ne fushen e turizmit
- Ushtrimin e aktivitetit te rojeve civile.
- . Shoqeria ka te drejte gjithashtu te bashkepunoje me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ngjajshem me te

Aktiviteti i shoqerise shtrihet ne te gjithe territorin e Shqiperise dhe jashte saj. Qendra eshte e regjistruar ne librin e shoqerise "A.B.A.U."

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise me pernjegjesi te kufizuar "A.B.A.U." eshte ne Tirane, rruga Asim Vokshi, nr 90/1. Transferimi i mundshem i selise se shoqerise duhet te vendoset nga Asamblea e Ortakeve te Shoqerise. Ajo gezon te drejten, me vendim te Keshillit Administrativ dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar, te krijoje ne Shqiperi apo jashte vendit filiale, perfaqesi apo dege te tjera, mbeshtetur ne kriter te miratuara nga organet perkatese, si dhe ne legjislacionin e vendit ku ato hapen.

NENI 4

KOHEZGJATJA

Jeteqjlesia e shoqerise me pernjegjesi te kufizuar "A.B.A.U." eshte mbi 10 vjet. Ajo mund te shperndahet perpara ketij afati me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve, ose kur verifikohen rrethana te tilla, ne te cilat shperndarja e saj urdherohet ne menyre te prere nga ligji.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT OSE PJESET

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise "A.B.A.U." eshte 100.000 leke, kuotat e te cilit jane te ndara ne kete menyre:

1. Ahmet Ulaj	50% te kuotave
2. Astrit Ulaj	50% te kuotave

Kapitali baze (fillestari) mund tu kthehet ortakeve vetem ne castin e likuidimit te shoqerise apo ne castin e terheqjes se kuotes se ortakut, duke mbajtur parasysh ecurine dhe rezultatet e aktivitetit, sikurse percaktohet ne statut dhe ne kontraten e themelimit.

Me vendim unanim te asamblese te jashtezakonshme te ortakeve, keta mund te rrisin kapitalin baze me marreveshje te mevonshme, ne menyre proporcionale me kuotat e pjesemarrjes. Ortaket marrin pjese ne krijimin e kapitalit baze me kuotat e tyre qe percaktohen ne kontraten e krijimit te shoqerise. Menyrat dhe afatet e derdhjes se kuotave te kapitalit te shoqerise percaktohen ne kontrate.

Kapitali shoqeror mbyllte me 31 dhjetor te cdo viti dhe bilanci duhet aprovuar brenda kater muajve te ardhshem.

NENI 6

Pjeset respektive te kapitalit themeltar jane nenshkuar dhe shlyer teresisht nga ortaket duke u depozituar ne Banke, sipas vertetimit qe i bashkohet ketyre akteve.

Kapitali eshte i ndare ne aksione me vlore nominale te barabarte prej 1000 leke.

Ne asnjë rast kontributet ne kapitalin themeltar te shoqerise nuk mund te perfaqeshen ne letra me vlera te tregtueshme apo sherbime.

NENI 7

Kuotat ose pjeset jane nominative dhe lirisht te transferueshme midis ortakeve. Transferimi i tyre behet vetem me akt notarial dhe cdo transferim tek te tretet i nenshtrohet te drejtes se parablerjes nga ortaket. Kuotat e pjesemarrjes ne kapital jane te gjitha te emertuara e te pandashme. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 8

Per transferimin e kuotave te treteve ortaku duhet te njoftoje shkreserisht shoqerine, e cila brenda tre muajve nga dita e marrjes dijeni duhet te jape vendimin lidhur me sa me siper, vendim i cili nese nuk jepet ne kete afat liron nga detyrimi ortakun cedues.

Ndersa nese ortaket e tjere pranojne te ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes, kete duhet ta bejne brenda tre muajve. Ne te kunderten kuotat jane te lira t'u transferohen te treteve. Ortaket mund t'ua kalojne kuotat e tyre ortakeve te tjere brenda shoqerise ne rast se keta te fundit do t'i pranojne dhe pastaj kane te drejte t'ua kalojne ortakeve te tjere jashte kesaj shoqerie. Nese lind nevoja per vleresimin e kuotave, ortaket caktojne ekspert. Kur nje gje e tille nuk arrihet me marreveshje mes tyre, me kerkesen e njerit prej tyre, caktimi i ekspertit behet me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane.

NENI 9

Ndryshimet ne kapitalin themeltar te shoqerise behen vetem me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve.

Shoqeria ka te drejte, kur bie dakord, te lere peng nje pjese te kapitalit te saj themeltar. Ne rast shitje te detyruar te pjeseve te lena peng, pengmarresi do te pranohet si person te cilit i jane transferuar kuota te kapitalit themeltar te shoqerise, me perjashtim te rasteve kur shoqeria preferon t'i ribleje keto pjesa e te deklaroje zvogelimin eventual te kapitalit te saj themeltar.

KREU III

ORGANET E SHOQERISE

NENI 10

Organet e shoqerise jane:

- Asambleja e Ortakeve
 - Keshilli Administrativ
 - Administratori, ose drejtor i pergjithshem
- Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "A.B.A.U. "Vendimet e saj ne perputhje me ligjin dhe normat e ketij statuti jane te detyrueshme per te gjithe ortaket, duke perjashtuar te drejten e tyre te ankimit kunder veprimeve qe ata i cmojne te demshme per interesat e tyre.



NENI 11

Organi vendimor e shoqerise me perjegjesi te kufizuar "A.B.A.U." eshte Asambleja e Ortakeve. Kjo Asamble zgjedh Keshillin Administrativ i cili nga ana tij, zgjedh administratoret qe do ta perfaqesojne ne marredhenie me te tretet.

Asambleja mblidhet ne sesione te zakonshme dhe te jashtezakonshme. Administrator do te jete z.Ahmet Ulaj . Ne mbledhjet e zakonshme ajo shqyrton dhe vendos per cestje te tilla si emerim apo shkarkim te administratorit, caktim eksperti, kontabilisti dhe likujduesi te autorizuar; miraton raportet e administrimit dhe kontrollit; miraton llogarite vjetore, ndarjen e fitimit, etj. Ne mbledhjet e jashtezakonshme Asambleja e Ortakeve vendos per cestje te tilla si ndryshimet e statutit, zvogelimi e kapitalit themeltar tek te tretet, zgjatja e kohes se veprimtarise se shoqerise apo likuidimi i saj.

NENI 12

Shoqeria me perjegjesi te kufizuar " A.B.A.U. " vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejta dhe detyrimet. Ajo per gjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore e jashtekontraktore brenda kapitalit te saj. Ortaket mbartin rrezikun per veprimtarine e shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te kapitalit te investuar ne rastin e krijimit te shoqerise.

Ortaket qe zoterojne te pakten 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise mund te kerkojne gjyqesisht caktimin e nje eksperti kontabel per verifikimin e nje operacioni apo te veprimtarise se shoqerise ne teresi.

NENI 13

Shoqeria drejtohet nga nje ose me shume administratore qe duhet te jene persona juridik, si dhe mund te jene ortak ne shoqeri ose jo. Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe konsiderojne te nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise, ata kane te drejte, midis te tjerave, te blejne e te kembejne pasuri, te lidhen me shoqeri te tjera te ngritura ose qe do te krijohen si brenda ashtu dhe jashte shtetit, duke siguruar pjesemarrje per qellimet e veprimtarise ekonomike.

Emerimi administratori behet per nje kohe gjatje prej tre vjetesh, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem.

Ne marredhenie me ortaket ose me te tretet, administratoret kane te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise e ne emer te saj. Administratoret jane perjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit, ose per fajet e kryera gjata administrimit.



NENI 14

Ne rast nevoje ose kur e kerkon ligji, kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar nga ortaket e shoqerise. Ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur shkarkohet, shkarkimi i te cilit vendoset me te njejten menyre si dhe emerimi i tij.

NENI 15

Shoqeria administrohet nga Keshilli Administrativ, i perbere nga nje numer tek i ndryshueshem anetaresh, nga tre deri ne pese, qe emerohen dhe shkarkohen nga Asambleja e zakonshme e Ortakeve. Ata qendrojne ne detyre deri ne heqjen e tyre nga Asambleja, qofte edhe pa te drejte, apo per efekt doreheqje. Ne rast se hiqen ose pushojne se funksionuari me shume se gjysma e administratoreve, ata qe mbeten duhet te mbledhin sa me shpejt Asamblene e Ortakeve per te proceduar lidhur me rinvimin e te gjithe Keshillit Administrativ.

I takon Asamblese se zakonshme te Ortakeve te vendose edhe per numrin e anetareve te Keshillit Administrativ.

Secili anetar i Keshillit Administrativ gezon te drejten e nje vote te vetme.

Per t'i bere te vlefshme vendimet e Keshillit Administrativ kerkohet prania e shumices se anetareve, pavaresisht nga prania e revizoreve. Vendimet merren me unanimitet. Keshilli Administrativ gezon fuqi te medha per administrimin e zakonshem e te jashtezakonshem te shoqerise, pa asnje perjashtim apo rezerve, me perjashtim te rasteve te parashikuara ne kompetence te Asamblese se Ortakeve.

Ky Keshill ushtron edhe kompetencat qe vijojne:

- miraton planet dhe projekt-bilancet qe do t'i paraqiten Asamblese;
- propozon ndryshimet e kapitalit baze qe do t'i paraqiten Asamblese;
- percakton dhe zgjedh kriteret e kontabilitetit dhe te administrimit te shoqerise;
- harton kontratat dhe, brenda shoqerise, ne vecanti, kontraten me personelin;
- percakton numrin e drejtuesve, i emeron ata, cakton detyrat dhe trajtimin ekonomik te tyre, si dhe marredheniet e punes;
- krijon, ndryshon dhe prish organizma te tjere qe mund te jene te nevojshem per realizimin e objektit te funksionimit te shoqerise;
- ben propozime te tjera ne Asamble lidhur me perdorimin e fonave te vecanta, ndarjen e fitimit si dhe mbylljen e mundshme te shoqerise;
- percakton njesi te tjera te mundshme te shoqerise si filiale, etj.

NENI 16

Kuotat e shoqerise jane te transferueshme sipas procedures qe vijon:



Ortaku qe ka per qellim t'ia dorezoje pjeserisht ose plotesisht kuoten e tij ortakut tjeter, me konsensus unanim te ortakeve te tjere, e ben oferten nepermjet nje letre te rekomanuar ortakeve dhe Keshillit Administrativ, duke treguar cmimin e kerkuar.

Ortaket e tjere kane te drejte te blejne kuoten e ofruar ne proporsion me pjesemarrjen perkatese ne shoqeri, duke e bere te ditur kete fakt brenda 30 diteve nga marrja e ofertes, por, me te mbaruar nje afat i tille, konsiderohet qe kane hequr dore nga blerja. Ne rastin e refuzimit nga ana ortakeve te tjere per te ushtruar pjeserisht ose plotesisht te drejten e zoterimit, ortaku terheq mund t'ua shese te treteve kuoten, por me nje cmim jo me te vogel se ai i bere ne oferten per ortaket e tjere.

NENI 17

Te gjithe te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin ne lidhje me aktivitetin e saj, duke vazhduar kete detyre edhe pas largimit te tyre nga kjo shoqeri.

KREU IV SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 18

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, si per humbje te kapitalit, pamundesi veprimtarie, ose me vendim te Asamblese. Ne kete rast vendoset mbi menyrat e likuidimit dhe caktohen nje ose me shume likuidatore, duke u percaktuar detyrat. Keta kujdesen qe ne rradhe te pare te shlyhen detyrimet qe shoqeria u ka personave te trete.

NENI 19

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te beje Asambleja e Ortakeve, si dhe ligjeve te vecante te legjisacionit shqiptar.
Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne te njejtene menyre dhe procedure me te cilen nxirret vete statuti.

NENI 20

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me kontraten e punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjisacionit shqiptar te punes.
Kjo eshte e njezte edhe per filialet, zyrat e perfaqesise apo agjencite.

Ky statut firmoset rregullisht nga ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "A.B.A.U. ".

ORTAKET

Ahmet Ulaj

Astrit Ulaj



REPUBLICA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
Nr. 1464 Rep.
Nr. 202 Kol.

V E R T E T I M

Sot, me dt. 23/10/1998, ne Zyren e Noterise Tirane u paragiten personalisht para meje noteres kerkuesit.

1. Ahmet Ulaj, i biri i Ises e Zades, i dtl. 1951, banues ne Tirane, rruga Asim Vokshi, nr.. 90/1
2. Astrit Ulaj, i biri i Ises dhe i Zades, i dtl 1964, banues ne Tirane, rruga Asim Vokshi, nr.90/1.
te panjohur prej meje, per identitetin e te cileve u informova nga dokumentat qe ata mbanin madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar. Ata deklaruani se statuti dhe akti i mesiperm te redaktuar jashte kesaj zyre, jane bere sipas vullnetit te tyre te lire e te plete dhe e nenshkruan ate rregullisht. Une noterja e gjej kete veprim ne perputhje me ligjen dhe e firmos rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

Marija Bushati

PULLE TAKSE